

Siguri

Ekskluzive | Ky është i dyshuari për kanosjen e një 37-vjeçari me kallashnikov në Obiliq



Sinjali.com

30 Korrik 2026 08:39



Një konflikt në Obiliq ka përfunduar me arrestimin e një 22-vjeçari, pasi dyshohet se ka kanosur një person me kallashnikov, ndërsa Policia gjatë bastisjes ia ka sekuestruar armën.

Sinjali mëson se i arrestuari është Shaban Preniqi (22-vjeç), ndërsa viktimë e rastit është M. Mjekiqi (37-vjeç).

Sipas burimeve, viktimja është paraqitur në Stacionin Policor në Obiliq dhe ka raportuar se ishte kanosur me armë nga i dyshuari. Ai ka dorëzuar edhe një video-incizim, ku Shaban Preniqi shihej duke mbajtur armën në dorë.

Pas marrjes së informacionit, Njësia e Hetimeve, së bashku me Njësine Reaguese dhe me urdhër të Prokurorit të Shtetit, ka bastisur shtëpinë e të dyshuarit.

Gjatë bastisjes, një familjare ka dorëzuar një pushkë automatike AK-47, së bashku me një karikator, të cilat janë sekuestruar si prova materiale.

Me urdhër të Prokurorit, ndaj Shaban Preniqit është iniciuar procedurë për veprat penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Kanosja”, ndërsa ai është dërguar në ndalim për 48 orë në Qendrën e Ndalimit në Prishtinë.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera